

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kunder te pandehurit A.I.nga Gj., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 7369/16, të datës 14.03.2017, jashtë seancës, me datë 15.01.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr. 7369/16, të datës 14.03.2017, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

A.I., nga i ati O. ,dhe e ëma Sh. e vajzërisë S., i lindur menë Gj., me vendbanim në rr.“V.F.”, nr.... Gj., me numër personal ..., ka të kryer Shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me date 12.12.2016,rreth orës 18:15, në lokalin “E.-A.”, në lagjen D. në P., i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja vetës ti sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka vepruar në atë mënyrë me që rast ka shkuar në lokalin në fjalë, ka hyrë brenda dhe nga aty ka marrë një jakne të cilën e ka veshur ndërsa jaknën e tij të vjetër e ka varur në varëse , e më pasë kur ka dashur të largohet pa e paguar të njëjtën në arkë, duke dalë jashtë i pandehuri është vrejtur nga punëtori i ati lokali B.S., i cili ka arritur ta ndaloj të pandehurin dhe të njëjtiti i ka marrë jaknën e vjedhur,-

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) vite nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 7369/16, të datës 14.03.2017, kundër të akuzuarit A.I.nga Gj., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenet 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Vërtetimi mbi marrjen e sendeve e datës 12.12.2016, me nr.,2016-AD-3862, si dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve të datës 12.12.2016, Kallëzimi penal, Deklarata e dëshmitarit, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenet 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.1287/17, të dt. 15.01.2018

Zyrtare Ligjore
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.